



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA Durrës**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 47, datë 23.07.2025

**PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.16, DATË 21.05.2025 PËRSA I PËRKET ZNJ. DAJANA LUMI, Z. LIRIM MURRJA DHE Z. MENTOR MUJA**

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr.97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 27.11.2019, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 16, datë 21.05.2025 “Për miratimin e ndryshimit të Vendimit nr. 30, datë 26.03.2021 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për Pallatin nr. 1032, Rruga “Aleks Komneni” dhe Pallatin “Kastrati”, Rruga “Ramadan Velu” të dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, të ndryshuar”, Urdhërit nr. 135, datë 01.03.2021 të kryetares së Bashkisë Durrës “Për ngritjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave të aplikantëve jofitues që nuk janë përzgjedhur nga programet e procesit të rindërtimit me nivel dëmi DS4-DS5”, i ndryshuar si dhe sipas relacionit të hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,


**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I :**

1. Miratimin e një ndryshimi në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 16, datë 21.05.2025 përsa i përket shpalljes si përfituese të znj. Dajana Lumi sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 76, datë 28.06.2021 dhe sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5, Bashkia Durrës.
2. Miratimin e një ndryshimi në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 16, datë 21.05.2025 përsa i përket shpalljes si përfitues të z. Lirim Murrja sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 30, datë 26.03.2021 dhe sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5, Bashkia Durrës.
3. Miratimin e një ndryshimi në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 16, datë 21.05.2025 përsa i përket shpalljes si përfitues të z. Mentor Muja sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 76, datë 28.06.2021 dhe sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5, Bashkia Durrës.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Komisioni i Posaçëm për Vlerësimin dhe Përzgjedhjen e Përfituesve nga Programet e Procesit të Rindërtimit si dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**ZËVENDËSKRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK DURRËS**

**Denisa Luarasi**



**U shpall sot me datë 24.07.2025**




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 511 / 11 prot.

Durrës, më 24 . 07 . 2025

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK  
Durrës  
KRYETARIT TË BASHKISË  
Durrës



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës nr. 47 datë 23.07.2025 “Për miratimin e një ndryshimi në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 16, datë 21.05.2025 përsa i përket znj. Dajana Lumi, z. Lirim Murrja dhe z. Mentor Muja”.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”i ndryshuar (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karkater individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

PREFEKTI  
EMILJAN JANI

